



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:269940

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05577228

**C-IV-14-6023**

*Paditësi/Ankuesi*

**H E** nga fshati G, Prizren, të cilin e përfaqëson avokat **S R** Prizren

*Kundër*

*E paditura/Pala kundërshtare*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP (NSH “Progres” – “Lavërtari – Blegtori” në likuidim)**, Rr. “Dritan Hoxha” 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (“DHPGJS”), kolegji i përbërë nga Gazmend Sylaj, gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Bajram Miftari, gjyqtar, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 16 prill 2024, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM  
PËR MOSPARAQITJE**

- 1. Ankesa hedhet poshtë.**
- 2. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me 28 gusht 2014, pranë DHPGJS, ankuesi, parashtron një ankesë me të cilin e kundërshton NJOFTIMIN e Autoritetit të Likuidimit (AL) të AKP, datë 16 korrik 2014 pa numër të qartë protokoli, me të cilin njoftim, kreditorët, janë informuar mbi iniciimin e procedurës së likuidimit NSH “Progres” – “Lavërtari – Blegtori”.

Ankuesi me ankesë, i referohej dispozitave ligjore të Ligjit të AKP dhe Shtojcës së po këtij ligji ( si nenin 2, 3, 11, 14, 7, 9 dhe 49).

Ankuesi me ankesë ka përshkruar kompetencat e Bordit të AKP, referuar në atë se anëtarët ndërkombëtar të Bordit mund të ndalojnë të gjitha Vendimet e Bordit, nëse konsiderojnë se është në kundërshtim me Konventën Evropiane mbi Liritë dhe të Drejtat e Njeriut gjer në vendimin përfundimtar të DHPGJS.

Nga kjo arsye konsideron se edhe Vendimet e AL nëse konsiderohen se janë në kundërshtim me KELDNJ mund të apelohej pranë DHPGJS dhe veprimet e AL të ndalohen gjer në vendimin përfundimtar të gjykatës.

Ankuesi pohon se pranë DHPGJS, ka parashtruar një padi, e evidentuar sipas numrit C.nr. 664/02, padi kjo e parashtruar pranë Gjykatës Komunale në Prizren, me të cilën ka kërkuar anulimin e Kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, Ov,br, ..datë .. tetor...

Gjykata Komunale në Prizren (tani gjykata themelore) me Aktvendimin e saj, datë 30 maj 2011, është shpallur jo-kompetent.

Ankuesi tutje, pohoj se ka parashtruar një padi të dytë pranë DHPGJS e cila pranë kësaj gjykate evidentohet sipas lëndës C-IV-13-3157.

Nga kjo arsye, ankuesi konsideron se fakti se pranë DHPGJS zhvillohet një procedurë gjyqësore e karakterit pronësor, atëherë procedura e likuidimit duhet të ndërpritet për të vetmen arsye se ka të bëjë me kërkesë pronësore e jo edhe monetare.

Ankuesi pretendon në të drejtën e tij mbi anulimin e Kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, bazuar në dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve si dhe të drejtën e pronësisë së ngastrës kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 00.55.31 ha, zona kadastrale T.

Nga gjitha arsyet u kërkuar që gjykata ta shfuqizoj Vendimin- njoftimin mbi inicimin e procedurës së likuidimit të NSH.

Kërkesës- ankesës i janë bashkangjitur:

- Kopja e padisë e parashtruar pranë DHPGJS ( pa vulë pranimi),
- Kopja e Aktvendimit të Gjykatës komunale Prizren (tani themelore), P.br. 664/02 datë 30 maj 2011, mbi jokompetencën,
- Një kopje e parashtrësës, sipas lëndës SCC-11-0280, dhe
- Kopjen e noterizuar së autorizimit, për përfaqësuesin.

Me datë 11 tetor 2022, ankuesi parashtror një precizim të ankesës, ashtu që kërkoj anulimin e Kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, Leg.nr..datë .. janar.., si dhe të drejtën e pronësisë së ngastrës kadastrale nr..., sipas fletës poseduese nr., në sipërfaqe prej 00.55.31 ha, zona kadastrale T.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 4 nëntor 2022 parashtror përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën e ankuesit duke e konsideruar si të pabazuar. AKP tutje pohoj se AL ka bërë një vlerësim të saktë si dhe dispozitat ligjore i ka aplikuar në mënyrë të drejtë. AKP gjithashtu pohoj se ankesa nuk përmban argumentet ligjore ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP si dhe Ligjit për procedurën kontestimore. AKP përfundimisht pohoj se ankuesi nuk i është përmbajtur kërkesës së AL, drejtuar ankuesit, mbi informatat dhe dokumentacionin shtesë lidhur me pretendimet e tij pronësore. Nga gjitha arsyet propozon që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Përgjigja e AKP ju dorëzua përfaqësuesit të ankuesit me 29 nëntor 2022.

Nuk u parashtrua përgjigje.

Gjykata ftoj palët për seancën e parë dëgjimore, të caktuar për datën 11 prill 2024, me fillim në ora 10.00.

Paditësi/ankuesi si dhe përfaqësuesi i tij munguan. Ishin ftuar në mënyrë të rregullt. Nuk është pranuar ndonjë njoftim, pranë DHPGJS, me të cilën do të arsyetohej mungesa, si e ankuesit /paditësit por edhe përfaqësuesit të tij.

Kolegji konstatoj prezencën në sallë të Avokatit, N M nga Prizreni i cili nuk kishte autorizim për përfaqësim. I njëjti deklaroi se ka menduar që seanca e sotme zhvillohet sipas padisë pronësore e cila zhvillohet sipas padisë C-III-12-0648, lëndë kjo që sipas kopjes së padisë së prezantuar zhvillohet pranë DHPGJS. Avokati, N M, tutje deklaroi se nuk ka autorizim për përfaqësimin e ankuesit H E sipas lëndës objekt i këtij shqyrtimi.

Përfaqësuesi i AKP, propozoj kolegjit lëshimin e aktgjykimit për shkak të mosparaqitjes, së ankuesit/paditësit.

### **Arsyetimi Ligjor**

Sipas nenit, 58.2 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr. 06/L-086) – (LDHPGJS) parashihet: “Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale”.

Paditësi por edhe përfaqësuesi i tyre, janë ftuar në mënyrë të rregullt për seancën dëgjimore të caktuar për datën 11 prill 2024. Megjithatë të njëjtit nuk janë paraqitur. Pasi që DHPGJS nuk ka pranuar asnjë njoftim me të cilin do të theksoheshin (si të bazuara) rrethanat të cilat ia kanë pamundësuar prezencën e tyre në seancë si dhe duke pasur parasysh kërkesën e përfaqësuesit të paditurës që të merret Aktgjykim në mungesë, kolegji vlerëson se kushtet ashtu siç janë të parapara në nenin 58.1 dhe 58.2 të Shtojcës janë plotësuar.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv.

### **Shpenzimet**

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv.

### **Këshillë juridike**

Në pajtim me nenin 59.1 dhe 59.2 të LDHPGJS, cilado palë mund të parashtrojë një kërkesë në DHPGJS për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje.

Kërkesa për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje duhet të parashtrohet brenda një muaji nga dita e dorëzimit të aktgjykimit për mosparaqitje të pala gjegjëse.

*Gazmend Sylaj, Gjyqtar kryesues*  
*Diellza Hoxha, Gjyqtare*  
*Bajram Miftari, Gjyqtar*

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_